

DEKRET
Nr. 198, datë 8.4.2026

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e dekoratës “Kalorës i Urdhrit Suprem të Shqiponjës” zotit Gentian Ibrahim Toshkëzi

“Në vlerësim të meritave të veçanta të fituara në lëvrimin mbresëlënës të shkencave mjekësore dhe të praktikave më bashkëkohore në neurokirurgji në shërbim të shumë komuniteteve, si dhe për kontributet e çmuara shumëvjeçare në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të Diasporës Shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj